

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT I TELO ZA RAZMATRANJE NGAJAKI

Nr/Br. 677/26  
Datë/Datum. 29.04.2026

PRISHTINë

Plotësim i Raportit të Ekspertizës nr. 0127/2026- Blerina Huruglica

Sipas kërkesës së Panelit Shqyrtues me datë 28/04/2026, plotësohet raporti lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " FURNIZIM ME PIZHAME DIMRI DHE ÇORAPË PËR ZYRTARET POLICORË" nr. 214/30400-25-9367-1-1-1.

Fillimishtë ekspertja shqyrtuese sqaron se, OE ankues nga AK është eliminuar me arsyetimin se:

OE ka ofertuar për Pjesën 1 dhe Pjesën 2

OE ka dështuar ne Aneksin 1 te DT për 2 Pjesët si ne vijim:

Ne Aneksin 1 te DT kërkesa eshte

"Komplet qepja te jete e forte dhe e sigurt (qepje profesionale dhe penjéz profesional)"

OE ka paraqitur mostrat te cilat nuk përkojnë fare me kërkesat e AK

Qepja eshte e çrregullt, me fije te nxjerrura dhe joprofesionale shih ne foto:

Foto 1.

Foto 2.



Foto 3.



Foto 4.




Foto 5.

Foto 6.



OE ka dështuar ne mostër për Pjesën 1 (artikulli 3) dhe 2. Mostra e ofruar nga OE, nuk përmban asnjë dëshmi, tiket te përmbajtjes dhe prodhuesit, andaj oferta i refuzohet, nga pikat e larteshenuara OE eshte I paptergjegjshem.

Tutje, OE ankues në ankesë nuk mohon fotografitë e vendosura në arsyetimin mbi eliminimin e tyre, mirëpo pretendon se i plotëson kërkesat sepse fijet e perit nuk kanë qenë formë të ndaluara në dosje të tenderit.

Megjithatë bazuar në fotografitë e ofruara nga AK, krahasuar me kërkesat në Ankes 1, ku një ndër specifikat për përmbushje është qepja profesionale, atëherë si e tillë, këto fotografi vërtetojnë qepjen e çrregullt me fije të nxjerrura dhe jo profesionale.

Meqë rast sqarojmë se, me kërkesë të panelit shqyrtues për plotësim të raportit, është bërë nga AK që të më prezentohen edhe mostrat, për të cilat janë bërë edhe fotografi shtesë, ku rezultojnë se mostrat nuk janë me qepje profesionale, andaj sipas mendimit tim personal, qepjet e tiketave janë me tegele te devijuara, si dhe edhe nëpër disa pjesë shtesë ekziston qepje e dyfishhtë dhe me shumë fije të perit.


Andaj duke marrë parasysh se këto mostra përbëjnë pjesë të testit teknik të domosdoshëm për vlerësimin e tenderit dhe, sipas nenit 37.6 të RrPP-së, ku modeli i dorëzuar është ai që do të furnizohet AK-së dhe do të ruhet në depot e saj deri në përfundim të kontratës, atëherë kjo mostër konsiderohet jo në përputhje me specifikat teknike sa i përket qepjes profesionale, në kundërshtim me një ndër specifikat teknike:

- Ø Komplet qepja te jete e forte dhe e sigurt (qepje profesionale dhe penjës profesional)


Tutje, sipas vizitës së realizuar në AK me datë 29/04/2026 në orën 9:30, janë bërë fotografi për ti dëshmuar në plotësim të raportit.

**Mostrat e OE ankues:**

**LOT 1:**










Çorapet LOT 2:

Mostrat e OE ankues:



**Çorapet e OE të rekomanduar LOT 2:**





001 22 0043  
PAROLA E MARCHIO  
Per info: [info@haidix.com](mailto:info@haidix.com)  
TELEFONO: +39 0432 200000  
714/20400-20 0000-0-0-0

6

+39 0432 200 000  
[info@haidix.com](mailto:info@haidix.com)  
S.L. Via S. M. A. 1/0000, Frazzetta

**HAIIX**


**HEROES WEAR HAIIX**


**Multifunktionsecken  
Multifunctional socks  
Chaussettes multif.**

HAIIX

**Mostrat e OE të rekomanduar:**

**LOT 1**





**Krahasimi:**

- 1) OE I rekomanduar me numër rendor 1
- 2) OE ankues me numër 2



Si përfundim, bazuar edhe në vizitën e realizuar në AK lidhur me mostrat, si eksperte shqyrtuese sqaroj se, OE ankues pavarësisht se ofron një çmim më të ulët për 19,600 euro krahasuar me OE të rekomanduar, i njëjti ka paraqitur një mostër e cila konsiderohet si modeli që do të furnizohet AK, dhe sipas shqyrtimit tim konsideroj se kjo mostër nuk përputhet me specifikat e kërkuara në dosjen e tenderit.

Rrjedhimisht I mbetet panlit shqyrtues të analizoj se nëse nevojitet edhe një mendim shtesë nga një ekspert teknik.

A blue handwritten signature.